

CULTURAL DIVERSITY AND THE PRESERVATION OF THE CULTURE OF ORIGIN NORTH MACEDONIA – A CASE STUDY

Mirlinda Vejseli

University of Tetovo “Fadil Sulejmani”, Tetovo, North Macedonia, mirlinda.vejseli@unite.edu.mk

Abstract: Sociological studies often emphasize the belief that human relations are first cultural relations, and that culture and cultural identity play an especially significant role in other human relationships, such as: economic, social and political relations in society. Cultural relations matter not only in the size of relations between individuals or subgroups of different cultural affiliations, but also in the extent of the broader relations between different states and civilizations, and even in shaping philosophy and worldwide politics, playing a very important role during cohesion and conflict in modern and postmodern society. This idea is reinforced by sociologist Samuel Huntington, who in the book *Clash of Civilizations and the Remaking of world order* states that: "culture and cultural identities, which, at the broadest level are civilizational identities, are what shape patterns of cohesion, dissolution and conflict in the world" (Huntington, 2009, p. 16). Cultural diversity is the diversity of cultures, values, identities, and practices in each society. This includes changes in languages, beliefs, customs, traditions, and artistic expression. Cultural diversity is an aspect of the richness of societies, bringing change, innovation, and preparation to understand and evaluate different perspectives. Respecting and promoting cultural diversity, today in the world of cultural diversity, is essential to create an open, just, and free cultural environment. It is precisely the multicultural policies used to encourage respect and support for cultural diversity in institutions, education, and society at large. This is the aim of creating an environment where individuals of diverse cultural groups can coexist and contribute positively to society. Cultural diversity in North Macedonia is one of the main characteristics that constitutes the identity of this country. North Macedonia is home to a wide range of ethnic and cultural communities, including Macedonians, Albanians, Turks, Roma, Serbs, Bosniaks, etc. This diversity is evident in languages, culture, music, religious practices, etc. Efforts to preserve and promote cultural diversity in M.V. are essential to fostering cohesion and social understanding. The coexisting of diverse cultures contributes to the country's unique identity and heritage. It is important to recognize and respect the special contributions of each community by creating a more inclusive and harmonious society. This paper focuses on cultural diversity in M.V., preservation of culture of origin and the impact of diversity on cultural identity among The Albanians of North Macedonia.

Keywords: diversity, multiculturalism, identity, culture, origin.

DIVERSITETI KULTUROR DHE RRUAJTJA E KULTURËS SË ORIGINËS MAQEDONIA E VERIUT – RAST STUDIMOR

Mirlinda Vejseli

University of Tetovo “Fadil Sulejmani”, Tetovo, North Macedonia mirlinda.vejseli@unite.edu.mk

Abstrakt: Në studimet sociologjike theksohet shpesh mendimi se marrëdhëniet njerëzore janë së pari marrëdhënie kulturore dhe se kultura dhe identiteti kulturor luajnë rol mjaft të rëndësishëm edhe në marrëdhëniet e tjera njerëzore, të tilla si: marrëdhëniet ekonomike, shoqërore dhe politike në shoqëri. Marrëdhëniet kulturore kanë rëndësi jo vetëm në përmasat e marrëdhënies midis individëve ose nëngrupeve me përkatësi të ndryshme kulturore, por edhe në përmasat e marrëdhënies më të gjera midis shteteve dhe qytetërimeve të ndryshme, e madje edhe në formësimin e filozofisë dhe politikave mbarëbotërore, duke luajtur rol mjaft të rëndësishëm në ecurinë e kohezionit dhe konflikteve në shoqërinë moderne dhe postmoderne.

Kjo ide përforcohet nga sociologu Samuel Huntington, i cili në librin “Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror thekson se *“kultura dhe identitetet kulturore, të cilat, në nivelin më të gjerë janë identitete të qytetërimeve, janë ato që u japin trajtë modeleve të kohezionit, shpërbërjes dhe konfliktit në botë”* (Huntington, 2009, f. 16).

Diversiteti kulturor paraqet shumëllojshmërinë e kulturave, vlerave, identiteteve dhe praktikave në një shoqëri të caktuar. Kjo përfshinë ndryshimet në gjuhë, besime, zakone, tradita dhe shprehje artistike. Diversiteti kulturor është një aspekt i pasurisë së shoqërive, duke sjellë ndryshim, inovacion dhe përgatitje për të kuptuar dhe vlerësuar perspektivat e ndryshme. Respektimi dhe promovimi i diversitetit kulturor, sot në botën me laramani kulturore, është thelbësore për të krijuar një mjedis të hapur, të drejtë dhe pa paragjykime kulturore. Janë pikërisht politikat multikulturore që përdoren për të inkurajuar respektin dhe mbështetjen ndaj diversitetit kulturor në institucione, arsim dhe shoqëri në përgjithësi. Në këtë mënyrë synohet krijimi i një mjedisi ku individët e grupeve të ndryshme kulturore mund të koekzistojnë dhe të kontribuojnë në mënyrë pozitive në shoqëri.

Diversiteti kulturor në Maqedoninë e Veriut është një nga karakteristikat kryesore që përbën identitetin e këtij vendi. Maqedonia e Veriut është shtëpi për një gamë të gjerë komunitetesh etnike dhe kulturore, që përfshijnë maqedonasit, shqiptarët, turqit, romët, serbët, boshnjakët etj. Ky diversitete është i dukshëm në gjuhë, kulturë, muzikë, praktika fetare etj (Manjola Zaçellari, 2023, f. 171). Përpjekjet për të ruajtur dhe promovuar diversitetin kulturor në M.V, janë thelbësore për nxitjen e kohezionit dhe mirëkuptimit social. Bashkëjetesa e kulturave të ndryshme kontribuon në identitetin dhe trashëgimin unike të vendit. Wshtw e rëndësishme të njihen dhe respektohen kontributet e veçanta të secilit komunitet duke krijuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe harmonike.

Ky punim fokusohet në diversitetin kulturor në M.V, ruajtja e kulturës së origjinës si dhe ndikimi i diversitetit në identitetin kulturor tek shqiptarët e Maqedonisë sw Veriut.

Fjalët Kyçe: diversiteti, multikulturalizmi, identiteti, kultura, origjina

1. HYRJE

Studime mbi diversitetin kulturor dhe bashkëjetesën ndërmjet grupeve të ndryshme kulturore gjenden në literaturën sociologjike që në teoritë klasike. Diversiteti kulturor është emërtim i shoqërive modern. Në studimet e E. Durkheim “*The Problem With Diversity*” (Durkheim, 2022, p. 108), ai shpreh shqetësimin e tij në lidhje me diversitetin kulturor, ku thekson se çdo shoqëri ka nevojë për një nivel të caktuar të integritimit kulturor, me çrast të arrihet funksionimi i solidaritetit social. Shqetësimi kryesor i tij ishte se si në një shoqëri me diversitet kulturor të theksuar mund të vij deri te funksionimi i asaj shoqërie. Mendoni për një situatë ekstrem thekson Durkheim: paraqitni dy njerëz që flasin krejtësisht ndryshe gjuhët. Sa e lehtë do të ishte për ta që të vazhdonin një bisedë? Nëse do të ishte e nevojshme, ata padyshim mund të gjenin një mënyrë, por për çfarë mund të flisnin do të ishte e kufizuar dhe do të duhej shumë kohë për të pasur edhe një bisedë nga më të thjeshtat. (Durkheim, 2022, pp. 107-108). Diversiteti kulturor përfshin gjuhën, dialekte, vlera, sjellje normative, besime dhe supozimet për botën, e kështu me radhë. Sa më shumë që njerëzit të jenë të ndryshëm nga njëri-tjetrin, aq më e vështirë do të jetë për ta që të punojnë së bashku dhe të komunikojnë, gjë që është baza e çdo shoqërie thekson Durkheimi. Por ai më tej thekson se është vetëdija kolektive ajo që i bën njerëzit pavarësisht dallimeve të tyre, të gjejnë funksionimin dhe mirëkuptimin edhe në një shoqëri me diversitet. (Durkheim, 2022, p. 108).

Jetesa mes dy kulturave paraqet mundësi për gërshetim të elementeve kulturore nga dy sistemet kulturore, se këtejmi ata që jetojnë në mjedis të tilla nuk humbin asgjë, por e rrisin kapitalin e tyre kulturor.

Kulturologët amerikanë H. N. Seelye dhe J. H. Wasilewski, në studimin e tyre “Ndërmjet kulturave” ata gjithashtu analizojnë zhvillimin e identitetit personal brenda një bote ndryshimesh socio-kulturore (Seelye & Wasilewski, 1996, f. 54). Ata theksojnë se në rrjedhën e zhvillimeve shoqërore bashkëkohore, individët gjithnjë e më shumë po gjejnë rrënjët e tyre në dy kultura. Studimi i tyre, i referohet zhvillimeve kulturore në shoqërinë amerikane, ku diversiteti kulturor karakterizohet nga një sërë dukurish. Të jetosh brenda kufijve kulturorë do të thotë të zhvillosh identitetin personal në përputhje me trashëgiminë kulturore të grupit në të cilin bën pjesë. Kjo do të thotë të trashëgosh dhe të zhvillosh nacionalitetin, etnitetin, gjuhën, fenë e grupit tënd shoqëror, ndërsa të jetosh midis kufijve ndërkulturorë, do të thotë të ndryshosh gjuhën, zakonet, prioritetet vlerore, të cilat shpeshherë varen nga struktura shoqërore në të cilën këto grupe ndërveprojnë.

Studimi i Seelye dhe Wasilewski, identifikoi aspekte ku praktika e individëve që jetojnë ndërmjet dy kulturave përbëhet prej gërshetimit të elementëve kulturorë nga të dyja sistemet kulturore, çka nënkupton se këta individë të cilët shoqërizohen dhe praktikojnë modele kulturore të gërshetuara kanë mundësi të rritin kapitalin e tyre kulturor dhe shfaqin aftësi të lartë përshtatjeje me kushtet shoqërore të popullatës në shumicë (Seelye & Wasilewski, 1996, f. 64). Sigurisht, *të jetosh ndërmjet dy kulturash do të thotë të përballesh me sfida dhe vështirësi, nga njëra anë, dhe të fitosh shumëllojshmëri dijesh, praktikash dhe strategjish nga ana tjetër* (Seelye & Wasilewski, 1996, f. 65). Shpeshherë individët e grupeve të ndryshme etnike (autoktone), edhe pse shfaqin nivel të lartë integritimi ose përshtatje në shoqërinë në shumicë, janë të prirur të mbartin dhe të praktikojnë mënyrat e kulturës së origjinës së tyre.

Duke u bazuar tek mendimet e Seelye dhe Wasilewski sa i përket jetesës mes dy kulturash, dhe duke krahasuar me realitetin e Maqedonisë së Veriut mund të konstatojmë se, jetesa mes dy kulturash në MV, në veçanti mes shqiptarëve dhe maqedonasve, është një realitet i pasur dhe kompleks. Në këtë hapësirë gjeografike shpesh ndeshemi me një bashkëjetesë ku kulturat ndërthuren dhe ndikojnë reciprokisht (Vasilev, 2013). Shembull mund të merret përdorimi i shprehjeve maqedonas dhe shqiptare, gjithashtu janë huazuar zakone dhe tradita nga secili komunitet. Pavarësisht të gjithave nuk duhet anashkaluar fakti se veç të tjerash, ka raste ku ka pasur sfida dhe tensione ndërmjet këtyre dy kulturave, veçanërisht në lidhje me çështjen e gjuhës, arsimit dhe përfaqësimit institucional. Në Maqedoninë e Veriut përsëri disa ndryshimeve që janë bërë sa i përket respektimit të kulturave të tjetrit bazuar në kushtetutën e vendit, akoma ekzistojnë fërkime mes (shqiptarëve dhe maqedonasve) kur është në pyetje kultura, identiteti, gjuha etj (Asani, 2023). Respektimi i tjetrit ndodh si pasojë e një dialogu ndërkulturor, por

ky dialog mundë të bëhet tejet i vështirë në rastin kur pjesëmarrësit e perceptojnë njëri-tjetrin si përfaqësues të kulturave që kanë një marrëdhënie kundërshtuese me njëra-tjetrën (p.sh., si pasojë e një konflikti të armatosur të kaluar ose të tashëm) ose kur pjesëmarrësi beson se grupi i tij kulturor ka përjetuar dëme të konsiderueshme (p.sh., diskriminim të hapur, shfrytëzim material ose gjenocid) nga duart e një grupi tjetër, që perceptojnë se i përket bashkëbiseduesi (Cupeska, 2013). Megjithatë, ekzistojnë përpjekje për ndërthurjen e vlerave dhe dialogut ndërkulturor për të krijuar një mjedis të përbashkët dhe të harmonishëm.

Për dallim nga shumë vende tjera, të cilave multikulturalizmi si koncept dhe si sistem vlerash u është imponuar, Republika e Maqedonisë së Veriut diversitetin kulturor e ka të brumosur natyrshëm në thelbin e saj të ekzistencës shoqërore. Natyrisht, fjalën e kemi për përbërjen e saj faktike heterogjene, e jo për faktin se sa ky realitet multikulturor, i cili rrjedh nga dimensionet multi-etnik dhe multi-religjioz i Maqedonisë së Veriut, është reflektuar në sistemin politik, ekonomik, arsimor, shkencor, kulturor- institucional, mediatik, ushtarak e të sigurisë si dhe sisteme tjera të shoqërisë (Stojanov, 2024., f. 245). Duke patur parasysh faktin se shumica e njerëzve priren ta rruajnë kulturën e tyre, teza e vendeve multikulturore nënkupton idenë se bashkësitë e veçanta kulturore – etnike duhet ti gëzojnë të drejtat e tyre, ndërsa institucionalizim i këtyre të drejtave është mënyra më e mirë për të arritur plotësimin e një shoqërie pa dallime kulturore (Golubovic, 2019). Shumëllojshmëria dhe shtresat e ndryshme janë pjesë e pandashme e çdo bashkësie në çdo fazë të historisë. Shoqëritë janë shumëngjyrëshe dhe multikulturore thotë Martinello : “ *only cloning people by a particular matrix will enable the formation of mono-cultural and mono-identity society - vetëm klonimi i njerëzve me një matricë të veçantë do të mundësojë formimin e shoqërisë mono-kulturore dhe mono-identitare*” (Pajaziti, 2012, f. 27). Që le të kuptosh se në një të ardhme shumë të shpejtë as që do të mund të flasim për një shoqëri pa dallime kulturore, bota gjithnjë e më shumë shkon drejt një diversiteti dhe multikulturalizmi gjithëpërfshirës.

Bazuar në librin “Kultura dhe cilësia e jetës rasti Maqedoni”, autori A. Pajaziti thekson se *realiteti natyral i Maqedonisë është vërtet shumë kulturor, një shumëngjyreshmëri si ajo që quhet sallatë maqedonase, ku zarzavatet janë simbolikë e etniteteve që jetojnë në këtë shoqëri* (Pajaziti, 2011, f. 28).

2. METODOLOGJIA

Metodologjia e aplikuar në kuadër të këtij punimi është studimi i literaturës dhe zhvillimi i hulumtimit kuantitativ me etnitetet shqiptare. Numri i pjesëmarrësve në hulumtim ka qenë 480.

Në tabelën 1 janë paraqitur të dhënat demografike të mostrës sipas gjinisë, vendbanimit dhe nivelit të arsimit. Numri i pjesëmarrësve të gjinisë mashkullore të përfshirë në këtë hulumtim është 348 (72.5%), ndërsa numri i gjinisë femërore është 132 (27.5%). Në bazë të vendbanimit të subjekteve 209 (43.5%) prej tyre janë me vendbanim nga fshati, kurse 271 (56%) me vendbanim nga qyteti. Duke i'u referuar nivelit të arsimit i cili është vlerësuar nga niveli më i ulët që janë konsideruar nxënësit deri në nivelin më të lartë të arsimit subjektet me master/doktoraturë, tregohet se 6 (1.3%) subjekt të përfshirë në këtë studim janë me arsim fillor të kryer, 86 (17.9%) me arsim të mesëm të kryer, 167 (34.8%) me fakultet të përfunduar, 95 (19.8%) me master/doktoraturë, 109 (22.7%) janë student dhe 17 (3.5%) janë nxënës nga totali prej 480 (100%) subjekt të përfshirë në këtë studim.

Tabela 1: Të dhënat përshkruese të mostrës sipas gjinisë, vendbanimit dhe nivelit të arsimit

	Frekuenca	%	% Valide	% e akumuluar
Meshkuj	348	72,5	72,5	72,5
Femra	132	27,5	27,5	100
Fshat	209	43,5	43,5	43,5
Qytet	271	56,5	56,5	100
Arsim fillor të kryer	6	1,3	1,3	1,3
Arsim të mesëm të kryer	86	17,9	17,9	19,2
Fakultet të përfunduar	167	34,8	34,8	54,0
Master/Doktoraturë	95	19,8	19,8	73,8
Student	109	22,7	22,7	96,5
Nxënës	17	3,5	3,5	100
Total	480	100	100	

Burimi: autori

3. REZULTATE DHE DISKUTIME

Për ta përcaktuar efektin e marrëdhënies mes diversitetit ndaj shkallës së dimensioneve të identitetit kulturor të shqiptarëve të RMV-së si: vetëvlerësimi për ndjenjat kulturore, veshja dhe simbolet, muzika dhe arti, gjuha dhe feja, është përdorur koeficienti eta në katror.

Në tabelën më poshtë është paraqitur koeficienti i efektit të marrëdhënies së dimensioneve të identitetit kulturor nga shkalla e diversitetit. Koeficienti tregon se ($\eta^2=.498$) apo 49.8% e vetëvlerësimit për ndjenjat kulturore shpjegohet nga varianca e diversitetit, në radhë të dytë kemi efektin mbi gjuhën ($\eta^2=.465$) apo 46.5%, në radhë të tretë kemi efektin mbi muzikën dhe artin ($\eta^2=.425$) apo 42.5%, më pas kemi efektin ndaj fesë ($\eta^2=.370$) apo 37.0% dhe në fund ndaj veshjeve dhe simboleve me ($\eta^2=.168$) apo 16.8%. Sipas modelit të anovës për marrëdhënien e efektit të variabileve, të gjitha në pikëpamje statistikore janë domethënëse në nivel .01. Efekti negativ që ka diversiteti kulturor ndaj dimensioneve të identitetit të shqiptarëve të RMV-së raportohet si shumë i lartë në të gjitha aspektet, posaçërisht te vetëvlerësimi për ndjenjat kulturore dhe gjuha, ndërsa edhe ndikimi ndaj muzikës dhe artit raportohet si i lartë.

Tabela 2: Efekti i marrëdhënies së diversitetit ndaj dimensioneve të identitetit kulturor

	R	R Squared	Eta	Eta Squared
Vetëvlerësimi dhe ndjenjat kulturore * Diversiteti	-.528	.279	.705	.498
Gjuha * Diversiteti	-.480	.230	.682	.465
Veshja dhe simbolet * Diversiteti	-.145	.021	.410	.168
Muzika dhe arti * Diversiteti	-.468	.219	.652	.425
Feja * Diversiteti	-.497	.247	.608	.370

Burimi: autori

Në tabelën 3 është paraqitur analiza e regresionit të thjeshtë linear për ta përcaktuar përmasën e parashikimit të ndryshimit të identitetit kulturor të shqiptarëve të RMV-së nga shkalla e diversitetit si variabël parashikuese. Duke u bazuar në kushtet e përdorimit të analizës së regresionit, sipas të dhënave të fituara konstatuam se parakushtet janë plotësuar dhe se vlera e auto korrelacionit nga Durbin-Watson është 1.96 dhe vlera e influencës faktoriale brenda kufijve të lejuar, ndërkaq edhe analiza e rezidualëve të standardizuar në grafikun përkatës është homogjene dhe e pranueshme.

Tabela3. Modeli i përgjithshëm i parashikimit të identitetit kulturor nga diversiteti

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	.563 ^a	.317	.316	21.78597	1.967

a. Predictors: (Constant), Diversiteti kulturor

b. Dependent Variable: Identiteti kulturor

Burimi: autori

Sipas regresionit të përshtatur në tabelën 4, 31,6% e variancës së identitetit kulturor shpjegohet me shkallën e diversitetit kulturor ($R^2=.316$, $F(1,478)=221,879$, $p<0.01$), duke rezultuar si një model domethënës në aspektin

statistikor. Rezultati flet se diversiteti kulturor, si variabël parashikues, parashikon në mënyrë të vlefshme dhe të konsiderueshme nga pikëpamja statistikore variancën e nivelit të identitetit kulturor të shqiptarëve të RMV-së ($\beta = -.56, p < .001$). Hipoteza e parashtruar se *nëse rritet shkalla e diversitetit kulturor, atëherë do të ulet perceptimi për identitetin kulturor pranohet*.

Tabela 4: Përmasa e parashikimit të identitetit nga diversiteti kulturor

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients		Collinearity Statistics		
		B	Std. Error	Beta	t	Sig.	Tolerance	VIF
1	(Constan)	142.765	4.842		29.485	.000		
	Diversitei	-.947	.064	-.563	-14.896	.000	1.000	1.000

a. Dependent Variable: Identiteti kulturor

Burimi: autori

Ndikimi i diversitetit në identitetin kulturor të shqiptarëve në MV mund të jetë kompleks. Ndërveprimi mes elementeve të kulturës shqiptare dhe asaj maqedonase mund të sjell një identitet të pasur dhe unik për individët në këtë shoqëri. Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të kuptohet se këto procese mund të sjellin edhe sfida për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor të shqiptarëve në MV, në një mjedis të dominuar nga kultura maqedonase. Prandaj mbështetja në ruajtjen dhe promovimin e kulturës shqiptare është thelbësore për zhvillimin e shqiptarëve në MV. Për zhvillimin dhe promovimin (Placeholder19) e kulturës dhe identitetit kulturor rol kyç kanë edhe institucionet shtetërore. Edhe pse nga të dhënat që kemi analizuar shohim se subjektet janë skeptik ne mbështetjen e institucioneve për kulturën shqiptare, megjithatë sot të drejtë për zhvillimin e kulturës së origjinës kanë të gjithë etnitetet të cilat jetojnë në MV. Bazuar në kushtetutën e vendit, neni 48 ku theksohet:

“Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë që lirisht t’i shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë nacionale. Republika ua garanton kombësive mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar. Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore dhe artistike, shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre” (Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut., 2023.).

4. PËRFUNDIM

Pavarësisht se shqiptarët e Maqedonisë së Veriut e shikojnë diversitetin si rrezik për identitetin e tyre kulturor, diversiteti kulturor paraqet shumëllojshmërinë e kulturave, vlerave, praktikave dhe identiteteve në një shoqëri apo në një mjedis të caktuar. Diversiteti kulturor e frymëzon dialogun ndërkulturor, forcimin e identiteteve të ndryshme, dhe zhvillimin e një shoqërie pa paragjykime dhe të ndërgjegjshme për identitetin dhe kulturën e tjetrit. Diversiteti kulturor është burim i pasurisë dhe inovacionit që na lejojnë të përparojmë si shoqëri dhe si qytetarë të globit të bashkuar. Diversiteti kulturor është thelbësor për të krijuar një mjedis të bashkëpunimit, kur individët dhe komunitetet e ndryshme kulturore respektojnë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin, ata mund të ndajnë idetë, njohuritë dhe përvojat e tyre, duke krijuar një ambient shoqëror frytdhënës dhe përparues. Në një mjedis të tillë, çdo individ ndihet i vlerësuar dhe i përmbajtur, duke kontribuar në përmirësimin e shoqërisë në tërësi. Në Maqedoninë e Veriut, diversiteti kulturor duhet të shihet si mundësi dhe jo si mangësi, si urë për krijimin e një shoqërie multikulturore dhe multidiverse. *Përsëri sfidave, le të shohim mundësit, përsëri së kaluarës të luftojmë për të ardhmen, përsëri dallimeve të ndërtojmë një mozaik bashkimi.*

REFERENCES

- Asani, S. D. (2023). *Zhvillimet kulturore-historike te Shqiptarët në Maqedoni gjatë shekujve XIX-XX*. Shkup: Instituti i Trashigimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve.
- Cupeska, A. (2013). *Identitetet kulturore në politikë aspektet e multikulturalizmi*. Shkup: Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë.
- Durkheim, É. (2022, February 16). *The Problem With Diversity*. Retrieved from https://www.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/36039_5.pdf

- Golubovic, Z. (2019). *Unë dhe tjetri –shqyrtime antropologjike rreth identitetit individual dhe kolektiv*. Shkup: Logos-A.
- Huntington, S. (2009). *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror*. Shkup: Logos-A.
- Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut*. (2023, 01 25). Retrieved from <https://www.sobranie.mk/homeal.nspk:ustavrsm-al-ok.pdf>
- Manjola Zaçellari, L. S. (2023). Albanian Odonyms in North Macedonia as Means for Preserving Linguistic and Cultural Heritage . *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*.
- Pajaziti, A. (2011). *Kultura dhe cilësia e jetës-rasti Maqedoni*. Shkup: Logos-A.
- Pajaziti, A. (2012). *Culturological Studies: Education, Politics, Identity*. Skopje: Dauti Foundation & Institute for Political and International Studies.
- Seelye, H. N., & Wasilewski, J. H. (1996). *Between cultures : developing self-identity in a world of diversity*. Lincolnwood IL: NTC Pub. Group.
- Stojanov, S. (2024.). Multiculturalism and ethnicity in the pluralistic environment in the Republic of North Macedonia. *Vizione, Issue 42.*, 245.
- Vasilev, G. (2013). Multiculturalism in Post-Ohrid Macedonia: Some Philosophical Reflections. *SAGE Journals, Vol.27,No4*, P.685-708.